

V E N D I M
Nr.496, datë 21.10.1999

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË
POPULLSISË DHE BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”, si dhe të ligjit nr.8090, datë 21.3.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave.
2. Komisioni ka këto kompetenca:
 - I rekomandon Këshillit të Ministrave aktet ligjore dhe nënligjore për kryerjen e regjistrimit.
 - Harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të tij.
 - Cakton përbërjen e komisioneve vendore, si dhe zyra të regjistrimit në bashki dhe komuna dhe detyrat e tyre.
 - Ndan detyrat për institucionet e përfshira në procesin e regjistrimit.
3. Komisioni fillon funksionimin brenda datës 10.11.1999. Përbërja e komisionit parashikohet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përfshira në komision për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

**PËRBËRJA E KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË
POPULLSISË DHE BANESAVE**

- Zëvendëskryeministri dhe ministër i Koordinimit Qeveritar	Kryetar
- Ministri i Financave	anëtar
- Ministri i Pushtetit Lokal	“
- Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	“
- Ministri i Drejtësisë	“
- Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale	“
- Ministri i Arsimit dhe Shkencës	“
- Ministri i Punëve Publike dhe Transportit	“
- Ministri i Shëndetësisë	“
- Ministri i Rendit Publik	“
- Ministri i Mbrojtjes	“
- Ministri i Punëve të Jashtme	“
- Kryetari i Akademisë së Shkencave	“
- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës	“
- Kryeregjistruesi i Zyrës së Pasurisë së Paluajtshme	“
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore	“
- Dekani i fakultetit Ekonomik	“
- Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale	“
- Përgjegjësi i Sektorit të Demografisë (INSTAT)	“

- Përgjegjësi i Seksionit të Statistikës në
Departamentin e Statistikës, Informatikës dhe
Matematikës së Aplikuar në Fakultetin Ekonomik
- 3 specialistë të fushës

“ “